



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201900356/6

Tiranë \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

**Lënda:** *Rekomandohet vendosja e një kamere tjetër të sigurisë në koridorin hyrës të sektorit 1, të katit të parë, të Godinës nr.2 në IEVP Malësi e Madhe për të monitoruar në përputhje me standartet veprimitarë në koridorin e këtij mjeti si dhe përmirësimi i regjistrimit të pamjeve në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të tyre*

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Drejtorit të Përgjithshëm  
Z. Agim Ismaili  
Tiranë

*Inderuar Z. Ismaili,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e të dënuarit D. U., i cili pretendon se është dhunuar fizikisht nga një punonjës i policisë së IEVP Malësi e Madhe në dt. 03.03.2019, gjatë kohës që ai ndodhej në koridorin e sektorit 1, të katit të parë, të Godinës nr.2. Sipas shpjegimit të dhënë nga i dënuari, ai ka qenë duke pastruar shtupën në lavamanin e tualetit që përdoret nga punonjësit e policisë, kur njëri prej tyre e ka kapur me forcë nga rrobat dhe e ka përplasur në dysheme duke e lënduar në dorën e majtë.

Ndihmëskomisioneri i ngarkuar me detyrën për shqyrtimin e kësaj ankesë, ka shkuar në vend për të verifikuar ankesën në dt. 07.03.2019. Veprimet hetimore të kryera nga ndihmëskomisioneri në IEVP Malësi e Madhe janë si vijon: marrja e deklarimeve me shkrim të burgosurit D. U.; marrja e deklarimeve me shkrim punonjësit të policisë N. M.; kqyrja e Librit të Aktivitetit 24 orësh në Godinën nr.2, katër i parë, sektori 1; kqyrja e Regjistrat të konsultave mjekësore, në të cilin rezulton se i burgosuri D. Uka. është vizituar nga mjekia e IEVP-s në dt. 04.03.2019 dhe se ai ka pësuar *distraction digit i parë*; kqyrja e pamjeve të kamerave të sigurisë; marrja e shpjegimeve verbale nga mjekia e IEVP-ës Znj. H. V. dhe Drejtori Z. Gëzim Selimi. Pasi kërkua të administronim pamjet filmike të datës dhe vendit të ngjarjes, u vumë në dijeni me shkresën Nr.3131/1 Prot., dt. 09.04.2019 se, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kishte kryer një inspektim në IEVP Malësi e Madhe për të verifikuar këtë rast. Në përfundim të inspektimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka nisur procedim disiplinor për disa punonjës, ndër to edhe për punonjësin e policisë N. M., për tejkalim të forcës. N. M. është punonjësi i përfshirë në konflikt me të burgosurin D. U.

Meqenëse vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kryer një inspektim tematik për këtë ngjarje dhe ka marrë masa lidhur me pretendimin e të dënuarit, Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërprerë hetimin e rastit.

Nga kqyrja e pamjeve filmike dhe verifikimi në vend kemi konstatuar se, pamjet regjistrohen me kapërcime disa sekonda dhe nuk monitorohet i gjithë koridori ku ka ndodhur ngjarja.

Tualeti që përdoret nga punonjësit e policisë, ku pretendohet se është ushtruar dhunë, ndodhet në koridorin hyrës të sektorit 1, të katit të parë, të Godinës nr.2. Në të dy krahët e koridorit ka dhoma që përdoren për: magazinë, lavanderi, takime, depo dhe dushe. Hapësira e koridorit mbikqyret vetëm nga një kamera e vendosur jashtë zgarës hyrëse. Kjo kamera ka rreze monitorimi deri te tualeti dhe nuk monitoron hapësirën tjetër të koridorit, deri aty ku fillon holli i sektorit. E gjitha ngjarja e lartpërmendur, nga fillimi deri në fund, ka ndodhur në një hark kohor prej 6 minutash (19:24 – 19:30). Gjatë 6 minutave, pamjet kapërcehen disa herë dhe nuk të krijojnë mundësinë për të kuptuar qartë se çfarë ka ndodhur. Në pamje duken: lëvizje me ndërprerje të të burgosurit në koridor; kur ky ndodhet në afërsi të tualetit, është fiksuar një çast që ai tërhiqet nga rrobat nga një punonjës i policisë; më pas prania e disa punonjësve të policisë që nxjerrin nga sektori të burgosurin.

Mbikqyrja me kamera e të gjitha mjediseve në IEVP, përvèç atyre mjediseve ku cënohet privatësia, është vlerësuar nga ana jonë si një proçes thelbësor për tre arsyet:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjëshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambjenteve të burgimit dhe paraburgimit, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që eventualisht duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut*” si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*” i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.*”

### **RE KOMANDOJME:**

- Vendosjen e një kamere tjetër të sigurisë në koridorin hyrës të sektorit 1, të katit të parë, të Godinës nr.2 në IEVP Malësi e Madhe për të monitoruar në përputhje me standartet veprimtarinë në koridorin e këtij mjedisë si dhe përmirësimin e regjistrimit të pamjeve në mënyrë që të mos ketë ndërprerje të tyre.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**

Përgatiti: Adil Skuqi, Ndihmëskomisioner

